



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.47/2019

Prishtinë, më 15.3.2019

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Shemsi Syla, Teuta Haxhiu. dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviç dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Ismet Haziri-DKA Lipjan, Burim Bajrami-IARF, Besnik Radoniqi-KDI, Sanije Berisha-OSBE, Hazbije Sylejmani, Donjeta Jashari-United Youth Task Force dhe Zana Ulaj, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i Peticionit;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Të ndryshme.

## 1. Shqyrtimi i Peticionit ;

Kryetarja, konstatoi se Komisioni vendosi të mbahet mbledhja pa praninë e mediave.

Ajo tha, se sot, si pikë e rendit të ditës është Shqyrtimi i peticionit të një zonje e cila është ankuar lidhur me padrejtësitë që ajo mendon se po i bëhen në lidhje me punësimin. Për këtë e kemi ftuar në mbledhje ankuesen si dhe palët e involvuara në këtë proces. Ftesës i janë përgjigjur ankuesja, Inspektorati i Arsimit në Regjionin e Ferizajt dhe Drejtoria e Arsimit në Komunën e Lipjanit.

Hazbije Sylejmani, fillimisht bëri prezantimin dhe përgatitjet që ka. Ajo tha se deri në 31 gusht të vitit 2015, ka qenë me kontratë pune, si mësuese klase në një shkollë fillore të një fshati të Komunës së Lypjanit. Më pas ajo paraqiti kronologjinë se si ka rrjedh procedura e konkursit, si janë punësuar të tjerët që nuk kanë qenë me përgatitje përkatëse dhe pa përvojë pune, ndërsa ajo kishte 12 vite përvojë pune. Po ashtu, tha se në vitin 2019, është shpallur një pozitë e lirë me gjuhë dhe letërsi shqipe në një shkollë po të asaj komune dhe se në atë shkollë ka lidhur marrëdhënie pune një kandidate, pa u shpallur akoma konkursi, ndërsa tha se edhe për atë pozitë, ajo ishte më e kualifikuar se kandidatja e pranuar.

Në vitin 2018, në një shkollë ka qenë një pozitë e lirë dhe se një kandidate po ashtu u pranua në marrëdhënie të punës, pa e shpallur konkursin. Ajo tha se ka bërë ankesë në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit në Ferizaj, dhe kanë sjellë vendimin që duhet patjetër të shpallet vendi i lirë. Më pas, shpallet vendi i lirë dhe prapë pranohet kandidatja e cila nuk është me përgatitjet që duhet plotësuar në shkollat fillore.

Sylejmani tha se e ka lëndën në gjykatë dhe se është e gatshme të përgjigjet lidhur me çdo detaj.

Bujar Bajrami, tha se nga ankesa të cilën e kanë, mund të flasë për rastet e Shkollës “Shtjefën Gjeqovi” dhe “Kadri Beha”, dhe tha se në rastin e zonjës pjesërisht e kanë mbështetur ankesën. Më pas, shpjegoi procedurat dhe tha se nuk janë kompetent të kontestojnë mënyrën e poentimit që është bërë nga ana e komisionit vlerësues. Ai tha se kanë reaguar lidhur me ankesën e zonjës që të shpallen konkurset dhe ashtu ka ndodhur, ndërsa lidhur me vendimin e tyre, tha se nuk janë shkelur të drejtat e zonjës në fjalë dhe se ajo ka pasur të drejtë ankesë në shkallën e dytë.

Kryetarja, tha se nga ajo çka po shohim, rezulton se zonja ka qenë me e përgatitur dhe ka pasur përvojë pune me shume se sa të tjerët.

Mexhide Mjaku-Topalli, u tha se është marre një vendim më 9.1.2018 dhe janë parashtruar tri pika, ku mbështetet pjesërisht ankesa e zonjës dhe pas atij vendimi Drejtoria e Arsimit e Lipjanit ka shpallur konkurs, por nuk është pranuar zonja e cila punonte edhe pa konkurs. Pika e tretë e vendimit ka qenë që obligohet DKA-ja e Lipjanit që së pari të sistemojë mësimdhënësit që nuk e kanë orarin e plotë të orëve mësimore, a është aluduar në zonjën.

Bujar Bajrami, tha se kjo është bërë për të gjithë ata që nuk e kanë orarin e plotë dhe së pari është obligim që atyre tu plotësohet orari në pajtim me përgatitjen që kanë, e nëse atëherë ka mungese duhet të plotësohen me të tjerë.

Hazbije Sylejmani, tha se ne vitin 2015, lënda nga Drejtoria Regjionale e Arsimit në Komunën e Ferizajt është kthyer në favor të saj. Ajo foli edhe për disa kërcënime që ju kanë bërë nga familjarët e të pranuarve në punë, pse ajo ka bërë ankesë.

Saranda Bogujevci, tha se përveç kualifikimit është me rëndësi edhe përvoja e punës dhe pyeti çka është ndërmarrë ndaj komunës ku punësohet një person pa konkurs dhe është e çuditshme që hapet konkursi dhe prapë punësohet i njëjti person. Ky person dhe komuna kanë bërë shkelje herën e parë. Si është e mundshme inspektorati mos të ndërmarrë asgjë? A ka ndonjë formë se si e monitoroni procedurën e intervistimit dhe pranimit nga komisioni?

Bujar Bajrami, tha se çështja e vëzhgimit dhe e monitorimit, me asnjë ligj nuk na lejohet që të jemi prezent.

Lirije Kajtazi, tha se po shohim se lënda është në gjyq. Për çdo lëndë tjetër, përveç që është parim është edhe obligim që ndjen komisioni që mos të intereferojë në lëndët që janë në gjykatë. Kajtazi tha se ka parë një gatishmëri të organeve komunale për t'ju sistemuar në punë por deri tani nuk ka asnjë rezultat.

Veton Berisha, tha se meqenëse lënda është në procedurë gjyqësore, të vetmin veprim që mund ta bëjë komisioni, është një rekomandim për përshpejtim të procedurës gjyqësore lidhur me këtë lëndë.

Shemsi Sylja, tha materialet që i ka lexuar lidhur me këtë lëndë janë shqetësuese. Këto raste që po ndodhin me arsimin tonë, janë një dhimbje, dhe sa të paaftë jemi ne për të ardhur deri te një zgjidhje. Këto janë brengat e mia dhe besoj edhe të të gjithëve.

Kryetarja, tha se u pa që lënda është në procedurë gjyqësore. Me gjithë vullnetin e secilit nga anëtarët e komisionit për të ndihmuar, ne nuk kemi kompetencë të ndërhyjmë në lëndët që janë në procedurë gjyqësore. Do ta bëjmë një shpresë për përshpejtim të procedurës për shqyrtim të lëndës.

Nga ky moment, mbledhjen e drejtoi Mexhide Mjaku Topalli.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Mexhide Mjaku Topalli, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 7 shkurt 2019, u miratua pa vërejtje.

## **3. Të ndryshme**

Mexhide Mjaku Topalli, tha se të pranishme e kemi Donjeta Jasharin nga organizata Unitet Natoin Jouth Task Force, lidhur me një hulumtim të cilin do ta paraqesë.

Donjeta Jasahri, tha se është e angazhuar vullnetarisht si hulumtuuese, dhe erdhi këtu për të adresuar problemin e martesave të fëmijëve të komuniteteve. Në nëntor të vitit 2017, kemi publikuar raportin e fenomenit të martesave të hershme në komunitetet. Janë intervistuar mbi

500 respondentë dhe kemi arritur në përfundim se mbi 53% e këtyre respondentëve janë të martuar nën moshën 18 vjeçare. Prej shifrës 53 %, prej tyre 41% janë nën moshën 16 vjeçare dhe 84% e këtyre respondentëve, nuk e kanë të përfunduar arsimimin e obliguar me ligj. Këto janë shifra shumë shqetësuese. Hulumtimi është përcjellë edhe nga mediat dhe nuk kemi pasur një reagim nga Institucionet. Shumë shpejt do ta bëjmë publikimin e raportit për shkaqet e martesave të hershme në këto komunitete.

Veton Berisha, tha se në takimet e radhës është mirë këtë raport ta kemi dhe ta analizojmë. Ai tha se ka pasur reagime se raporti ka të dhëna që janë shifra të ngritura. Pyetësi është bërë në Fushë- Kosovë e në publik ka dal se këto të dhëna janë në nivel vendi. Ai tha se është mirë të bëhet dallimi sepse nuk ekzistojnë martesat e hershme të komuniteti egjiptian. Ne duhet të merremi seriozisht me rastet, të dihet saktë kush ka qenë respondentë, të çfarë niveli kanë qenë, ku duhet të reagojmë, kush janë aktorët sepse të dhënat janë ekzagjeruar.

Donjeta Jashari, tha se nuk është në njohuri se çka kanë publikuar mediat. Në Raport ceket vetëm Komuna e Fushë- Kosovës dhe hulumtimi është realizuar me pjesëtarë të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

Saranda Bogujevci, tha se është mirë të bëhet një hulumtim më i gjerë në vend e jo vetëm në Fushë- Kosovë, jo vetëm të komuniteteve, por për të gjithëve, në nivel vendi, dhe është mirë këtë nismë ta bëjmë ne si Komision.

Luljeta Veselaj-Gutaj, mbështeti idenë për një hulumtim në nivel vendi.

Mexhide Mjaku-Topalli, konstatoi se Komisioni Funkcional do të kërkojë nga Zyra për Hulumtime e Kuvendit, një hulumtim lidhur me martesat e hershme në Kosovë.

Më pas, ajo informoi anëtarët e Komisionit lidhur me takimin e Këshillit organizativ, lidhur me shënimin e 20 vjetorit të masakrës në Burgun e Dubravës.

Teuta Haxhiu, tha se si grup punues për persona të pagjetur, jemi të anashkaluar nga Komisioni Qeveritar për persona të zhdukur. Kemi kërkuar me shkresë se ku është në procedurë Projektligji për persona të zhdukur dhe ende nuk kemi përgjigjeje me shkrim. Është mirë në emër të Komisionit, ta bëjmë një shkresë dhe ku do të shprehim këtë pakënaqësi lidhur me bashkëpunimin me KQPZH-në.

Saranda Bogujevci, tha se ka informata se nga përfaqësuesit e ICMP-së në Kosovë, përfaqësuesi i ICMP-së për Ballkanin Perëndimor do të vijë për vizitë në Kosovë dhe se ka kërkuar që ky përfaqësues të ketë takim me Komisionin Funkcional Parlamentar. Ajo tha se po kërkon që nëse Komisioni është i pajtimit, ajo të ketë përgjegjësinë e përcjelljes së aktiviteteve për personat e zhdukur, sepse ka kontakte me aktorët kryesorë që janë përgjegjës, ndërsa deputetja Teuta Haxhiu me çështjen e Projektligjit.

Teuta Haxhiu, tha se kushdo që është i gatshëm ka mundësi të kontribuojë në çështjen e personave të zhdukur.

Saranda Bogujevci tha se tash e tutje do të abstenojë sepse për gjithçka, ju kam përkrahur dhe se po anashkalohen mendimet e saj dhe kjo nuk është e drejtë.

Shemsi Syla, tha se ka një kërkesë të cilën e ka edhe kryetarja e komisionit, që ka të bëjë me listat e kategorisë së personave të plagosur në periudha para luftës së UÇK-së dhe nuk janë të përfshirë në kategoritë që përfitojnë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është duke u punuar dhe me sa jam në dijeni për këtë çështje, në Komisioni për Shëndetësi. Është mirë ju ti njoftoni këta persona dhe të adresohen në Komisionin përkatës parlamentar, se a është përfshi edhe kjo kategori në atë skemë.

Selman Ymeri, tha se si administratë deri më tani nuk kemi asnjë informatë apo shkresë drejtuar Komisionit FunkSIONAL, lidhur me këtë çështje, dhe se ashtu siç e tha edhe kryesuesja është kompetencë e Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për çështjet që kanë të bëjnë me Projektligjin e ri për skemat pensionale të financuara nga shteti. Por, nëse eventualisht Komisioni FunkSIONAL vendos për ndonjë aktivitet tjetër, atëherë është në rregull.

Kryesuesja Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është një mundësi për mbajtjen e një punëtorie për përfundimin e shqyrtimit të Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës, dhe është një alternativë që punëtorja të mbahet të mbahet të hënën më 18 mars 2019.

Anëtarët e komisionit debatuan lidhur me datën e kësaj punëtorie dhe në fund të debatit kryesuesja konstatoi se Komisioni FunkSIONAL të hënën, më 18 mars 2019, do të mbajë punëtorinë e fundit në Prevallë, për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetarja e Komisionit,

---

Duda Balje